



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 16 nëntor 2022  
Kodi i ZRRE: V\_1636\_2022

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenit 48 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 paragrafi 1, Nenit 28 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 5, Nenit 8, Nenit 13, Nenit 17 dhe Nenit 19 të Rregullës Nr 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut(OST/OT);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 5, Nenit 8, Nenit 12, Nenit 16 të Rregullës Nr.05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Propozimin për Vlerat Hyrëse - Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve, të pranuar nga KOSTT SHA më datë 27 korrik 2022; dhe
- Propozimin për Vlerat Hyrëse - Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve, të pranuar nga KEDS Sh.A më datë 29 korrik 2022, në kuadër të Shqyrtimit të Tretë Periodik për Periudhën Rregullative 2023-2027.

në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2022 nxori këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHET** – Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3) 1 prill 2023 – 31 mars 2028 për Rrjetin e Transmetimit (OST) dhe Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH) sipas tabelës në vijim:

<i>Humbjet e lejuara</i>	<i>Njësia</i>	<i>2023</i>	<i>2024</i>	<i>2025</i>	<i>2026</i>	<i>2027</i>
<b>Lejimi i humbjeve për OST</b>	%	1.75	1.75	1.75	1.75	1.75
Caku i reduktimit të humbjeve	%		-	-	-	-
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50/50	0	0	0	0
<b>Lejimi i humbjeve për OSSH</b>	%	15.1	14.7	13.3	12.1	11.1
Caku i reduktimit të humbjeve	%	-	0.4	1.4	1.2	1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50/50	0	0	0	0

*Humbjet e lejuara në rrjete për periudhën e tretë rregullative*

- II. Faktori ndarës i humbjeve prej 50% do të zbatohet për OST/OT-në dhe OSSH-në vetëm në vitin e parë të periudhës rregullative.
- III. Në rast se humbjet e realizuara do të jenë më të vogla se humbjet e lejuara, të gjitha kursimet do të mbesin tek i licencuari përkatës, ndërsa në rast se nuk arrihen e gjithë kosto për mos arritjen e caktuar do të mbulohen nga të licencuarit përkatës.
- IV. Në vendosjen e caktuar të reduktimit të humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara, si emërues për kalkulimin e humbjeve në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes merren parasysh rrjedhat fizike të energjisë në tërë Republikën e Kosovës.
- V. Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara nuk aplikohet për sasi të energjisë së pa-faturuar në katër (4) komuna të veriut të Republikës së Kosovës.
- VI. Përshtatjet për kostot e humbjeve në baza vjetore sipas caqeve të këtij vendimi do të bëhen gjatë procesit të përshtatjeve vjetore.
- VII. **OBLIGOHEN** - Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A.) për zbatimin e këtij vendimi për Periudhën e Tretë Rregullative prill 2023- mars 2028.

## ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 26.05.2022 ka iniciuar Procesin e Shqyrtimit Periodik për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3) për të vendosur të Hyrat e Lejuara Maksimale (në tekstin e mëtejshme HLM) të të licencuarve OST/OT dhe OSSH, për periudhën 1 prill 2023 deri më 31 mars 2027.
- ZRRE ka njoftuar se në këtë proces të shqyrtimit periodik do të shqyrtoj vlerat hyrëse që do të shfrytëzohen për të përcaktuar HLM.
- ZRRE me datë 27 korrik 2022 nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ka pranuar propozimin për Cakun për Reduktimin e Humbjeve në kuadër të Shqyrtimit të Tretë Periodik për Periudhën Rregullative 2023-2027.
- ZRRE me datë 29 korrik 2022 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka pranuar propozimin për Cakun për Reduktimin e Humbjeve në kuadër të Shqyrtimit të Tretë Periodik për Periudhën Rregullative 2023-2027.
- ZRRE më datë 13 shtator 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ për Cakun për Reduktimin e Humbjeve në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes;
- ZRRE përmes Raportit konsultativ ka pasqyruar nivelin fillestar dhe shkallën e pritshme të reduktimeve të humbjeve në Sistemin e Transmetimit dhe Shpërndarjes.
- ZRRE përmes Raportin Konsultativ ka konsideruar se humbjet e realizuara nga KOSTT gjatë periudhës së kaluar rregullative janë në nivel eficient dhe në linjë me humbjet e realizuara nga operatorët evropian si dhe ata regional. Për këtë arsye, ZRRE nuk e sheh të arsyeshme të përcaktojë nivelin e humbjeve të KOSTT nën mesataren e realizuar të humbjeve gjatë periudhës së kaluar rregullative.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka konsideruar se përcaktimi i caktuar të humbjeve të KEDS bazohet në politikat e kaluara rregullative, planet investive, analiza teknike, të dhënat historike dhe të

parashikuara, si dhe praktikat rregullatore përfshirë edhe Draft Strategjinë e Energjisë për periudhën 2022-2031.

- ZRRE brenda afatit konsultativ publik për cakun e humbjeve për rrjetit e transmetimit dhe rrjetin e shpërndarjes, ka pranuar komente nga palët e interesit të cilat i ka prezantuar në Raportin Përfundimtar.
- ZRRE me datë 07 nëntor 2022 – ka publikuar Raportin Përfundimtar - Caku për Reduktimin e Humbjeve dhe Përgjigjet ndaj komenteve, të paraqitura nga palët e interesit në lidhje me Raportin Konsulltativ.
- OST/OT ashtu edhe OSSH-ja kanë dhënë përgjigje të detajuara ndaj propozimit për cakun e humbjeve të propozuara nga ZRRE.
- OST/OT propozoi që niveli i humbjeve të lejuara për PRR 3 të jetë 1.78%. KOSTT-i kërkon që faktori i ndarjes së humbjeve të jetë i vlefshëm për tërë periudhën rregullative 2023 - 2027, dhe jo, siç sugjeron ZRRE-ja, vetëm për vitin e parë të PRR3.
- ZRRE propozon që objektivi i humbjeve të lejuara për PRR 3 të mbetet ashtu siç është propozuar në Raportin Konsultativ, në vlerën 1.75%. Ky propozim bazohet në trendin e humbjeve të realizuara në vitet e fundit 2019, 2020 dhe 2021, si dhe paraqet një stimulim që Operatori i Sistemit të vazhdojë të operojë në nivelin e eficiencës ekzistuese. ZRRE përveç kësaj ka propozuar që faktori i ndarjes së humbjeve duhet të jetë 50% për vitin e parë të PRR3.
- KEDS-i ka theksuar se analizat dhe vlerësimet e bëra nga ZRRE nuk kanë dhënë argumente se si secili nga faktorët e shfrytëzuar nga ZRRE ka ndikuar në humbjet e propozuara. Propozimi i ZRRE për cakun e reduktimit të humbjeve bazohet në të dhënat historike pa u thelluar në aspekte teknike dhe analiza të detajuara.
- ZRRE vlerëson se caqet për reduktimin e humbjeve të OSSH-së në PRR3 janë vendosur në bazë të humbjeve të lejuara në fund të PRR 2, performancës së OSSH-së në PRR1 dhe PRR2, efektin e investimeve të realizuara, mundësit e reale dhe të arsyeshme të investimeve edhe në periudhën e ardhshme bazuar në përvojat nga PRR1 dhe PRR 2, praktikat rregullatore lokale dhe rajonale, si dhe trendet e reduktimit të humbjeve në vitet e fundit të OSSH-së të cilat janë në përputhje me caqet e propozuara të ZRRE-së për reduktimin e humbjeve të OSSH-së në PRR 3.
- ZRRE ka vendosur mos rishikimin e vlerës fillestare (bazë) të caktit të humbjeve, sepse rishikimi i saj për t'u përputhur me performancën aktuale të ndërmarrjes së rregulluar faktikisht nënkupton penalizimin e konsumatorëve për faktin se ndërmarrja e rregulluar nuk ishte në gjendje të arrinte cakun e saj për reduktimin e humbjeve. Prandaj, vlera fillestare do të jetë 15.1% dhe faktori i ndarjes së humbjeve duhet të jetë 50% për vitin e parë të PRR3.
- ZRRE ka vendos caqet për reduktimin e humbjeve si parameter rregullator në shqyrtime periodike tarifore shumëvjeçare duke marr parasysh efektin e investimeve të realizuara, dhe mundësit e reale dhe të arsyeshme të investimeve edhe në periudhën e ardhshme bazuar në përvojat e investimeve kapitale të implementuara nga OSSH krahas atyre të lejuara me Plane Zhvillimore Investive.
- ZRRE ka marr në konsideratë praktikat rregullatore që janë aplikuar në shqyrtimet periodike në të kaluarën, si dhe praktikat e rregullatorëve në regjion janë marrë në konsideratë në përcaktimin e nivelit të lejuar të humbjeve në shpërndarje.

- ZRRE në pajtim me rregullat e të hyrave, ka aplikuar mekanizmin nxitës rregullator për OSSH dhe OST/OT duke lejuar që i licencuari të mbaj ndryshimin e këtyre kostove si nxitje në përmirësimin e performancës.
- ZRRE ka marrë në konsideratë objektivat strategjike që adresojnë zvogëlimin e humbjeve të gjithmbarshme në sistem e me theks të veçantë edhe humbjeve jo-teknike për periudhën 2022-2031, sipas draft/Strategjisë së Energjisë.
- ZRRE-ja thekson se mund të jetë e mundshme që efekti i pandemisë mund të ketë shkaktuar ndërprerje të përkohshme në operimet e punës së ndërmarrjes, megjithatë nuk janë paraqitur dëshmi, për ta bindur rregullatorin, se si këto ndërprerje kanë shkaktuar një rritje kaq të konsiderueshme të nivelit të humbjeve.
- Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorës së humbjeve të lejuara aplikohet në territorin e Republikës së Kosovës, me përjashtim të katër komunave në veri të vendit, në të cilat të licencuarit (OSSH dhe OST/OT) nuk kanë kontroll. Derisa të licencuarit nuk kanë kontrollë në pjesën veriore edhe kalkulimet për çështje tarifore të humbjeve bazuar edhe në praktikën e deritanishme rregullatore do të bëhen me rrjedhat e energjisë pa përfshirë energjinë e pa faturuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.
- Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VIII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IX. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimin të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- (KOSTT SH.A),
- (KEDS SH.A), dhe
- Arkivit të ZRRE-së